



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:125746

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05542777

P.nr.882/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona Lajqi, me bashkëpunëtoren profesionale Medina Rama, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M. H., për shkak të veprave penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 dhe 1 pika 1.4 të KPRK-së dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1512/20 të datës 17.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 05.03.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni, të akuzuarit M. H. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. Xhelal Hasani, të dëmtuarit Xh. M., me datë 06.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 04.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. H., nga i ati A., e ëma V., e gjinisë I., i lindur me datë ... në Mitrovicë, tani me vendbanim në V., Mitrovicë, me numër personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I

SEPSE:

Me datë 17.09.2020, rreth orës 11:30 në rrugën “...” në Mitrovicë veri, i pandehuri me dashje i ka shkaktuar lëndime trupore personit tjetër dhe atë të dëmtuarit Xh. M., ashtu që fillimisht e godet veturën e të dëmtuarit me një shufër të drurit pastaj me të njëjtën shufër e godet edhe të

dëmtuarin Xh. duke i shkaktuar lëndime trupore dhe atë kontuzion në anën e djathtë të toraksit, dërrmishje në krahun e djathtë të shkaktuar nga ndonjë mjet i fortë dhe i rëndë mbretës që si të tilla paraqesin lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-Me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 dhe 1 pika 1.4 të KPRK-së.

II

Me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, i pandehuri me dashje ka dëmtuar veturën e tashmë të dëmtuarit Xh., ashtu që i pandehuri me një shufër të drurit e godet veturën e llojit Mercedes me targa regjistrimi ... pronë e të dëmtuarit Xh. M. me ç'rast i dëmton të njëjtën në pjesën e sipërme të automjetit mbi dyer.

-Me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 69, 70, 76, lidhur me nenin 181 dhe nenin 393 të KPRK-së, dhe neneve: 358, 359, 360, 364, 365, 366, 449, 452 dhe 460 të KPP-së, e:

G J Y K O N

I. Për veprën penale: Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 dhe 1 pika 1.4 të KPRK-së, me **DËNIM ME BURGIM ME KUSHT** në kohëzgjatje prej **dymbëdhjetë (12) muaj** nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, gjatë periudhës verifikuese prej dy viteve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

II. Për veprën penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, me **DËNIM ME BURGIM ME KUSHT** në kohëzgjatje prej **katër (4) muaj** nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, gjatë periudhës verifikuese prej dy viteve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 76 par.1 lidhur me par 2 nën par 2.2 të KPRK-së, të akuzuarit, i:

SHQIPTON

DËNIM UNIK ME BURGIM ME KUSHT në kohëzgjatje prej **katërmbëdhjetë (14) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, gjatë periudhës verifikuese prej dy viteve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

III. OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro ndërsa në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej njëzet (20) euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

IV. Pala e dëmtuar, nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1512/20 të datës 17.11.2020 kundër të akuzuarit M. H., për shkak të veprave penale për shkak të veprave penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 dhe 1 pika 1.4 të KPRK-së dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Fillimisht Gjykata, në këtë çështje penale me datë 01.06.2021 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin shqyrtim gjykata e ka njoftuar të pandehurin për të drejtat e tij dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë, i pandehuri ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprat penale sipas aktakuzës.

Gjykata me datë 05.03.2024 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në të cilin kanë prezantuar Prokurori i shtetit Ajtene Zoni, i akuzuari M. H., dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare Av.Xhelal Hasani, i dëmtuari Xh. M. dhe dëshmitari V. N.. Pasi që i akuzuari nuk e kishte pranuar fajësinë, gjykata ka administruar provat materiale dhe palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se, kjo aktakuzë është ngirutr pas grumbullimit të provave të mjaftueshme të cilat gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor do të vertetohen se i njëjti ka kryer veprat penale të cilat i bien në barë sipas kësaj aktakuze. Gjenjda faktike do të vertetohet pas degjimit të demtuarit-dëshmitari Xh. M. dhe dëshmitarit V. N. , si dhe pas administrimit të provave materiale të cilat janë propozuar që të shtejllohen gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjendja faktike sipas dispozitivave të aktakuzës qartë dhe bindshëm u vërtetuan sipas dëshmisë së dëshmitarit Xh. M. i cili pohoi faktin se pikërisht i pandehuri M. H. është personi i cili ka shkaktuar lëndime trupore e po ashtu ka demtuar veturën e të dëmtuarit, e po ashtu edhe nga deklarata e dëshmitarit V. N. u vërtetua fakti se në ditën kritike i pandehuri ka qenë prezent dhe se kishte verejtur se personi B. J. kishte ndërhyrë për të ndarë të pandehurin dhe të dëmtuarin, po ashtu edhe dëshmitari e pohoi faktin se i pandehuri ka qenë prezent në vend të ngjarjes, kjo është vërtetuar edhe nga leximi i deklaratës së dëshmitarit B. J., kjo ka mbeshtetje edhe në provat materiale të cilat u administruan të cilat vertetojnë se i dëmtuari në ditën kritike ka pësuar lëndime trupore e kjo vertetohet nga ekspertiza mjekoligjore nga mjeku N. H., si dhe fotodokumentacioni ku u vërtetua fakti se i pandehuri e ka demtuar veturën e të dëmtuarit, andaj duke u bazuar në të gjitha këto i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor për veprat e kryera penale, t'i shqiptoj një sanksion me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit dhe si rrethanë rënduese të ketë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale ndërsa lehtësuese në këtë rast nuk ka.

Mbrojtësi i të pandehurit M. H., av Xhelal Hasani, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i referohem deklaratës së të pandehurit në këtë shqyrtim gjyqësor i cili në mënyrë kategorike e mohon kryerjen e këtyre veprave penale dhe duke u arsyetuar se i njëjti nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes, sa i përket vepres së parë, ndërsa sa i përket veprës së dytë të marr Aktgjykim liruës duke konsideruar se vepra për të cilën akuzohet nuk përbën veper penale duke u bazuar në nenin 11 të KPRK-së tek vepra e rëndësisë së vogël, e në rastin konkret kemi të bëjmë me një veprë të tillë, dhe dëmi që është shkaktuar është një vlerë e vogël dhe nuk ka paraqitur ndonjë pasojë që nuk ka mundur të sanohet në gjendjen e mëparshme. Gjykata të merr parasysh si rrethanë lehtësuese se i mbrojturi im nuk ka rënë ndesh me ligjin më herët, i demtuari nuk paraqet kërkesë pasurore juridike dhe i propozoj gjykatës se me shqiptimin e dënimit me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari, M. H., në fjalën përfundimtare e ka përkrahur në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij.

Provat e administruara:

Gjykata, gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit të dëmtuarin Xh. M., është dëgjuar dëshmitari V. N., janë administruar provat materiale si në vijim: Kallëzimet penale me numër të rastit 2020-SA-190 të datës 24.09.2020, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit Xh. M., Procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit M. H., Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit B. J., Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit V. N., foto dokumentacioni, Raporti Policor nga S. U., Raportet mjekësore me numër 15624 për të dëmtuarin Xh. M. nga Spitali i Përgjithshëm Mitrovicë, Ekspertiza Mjekoligjore e datës 27.10.2020 nga Dr. N. H..

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.03.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar i dëmtuari Xh. M., i cil mes tjerave ka deklaruar se kemi qenë të parkuar si taksista në veri dhe ka ardhur një burrë dhe një grua në drejtim të veturës sime, unë i kam thënë taksi, me qëllim që ti marr si klient dhe më pas burri i thotë gruas së tij “hajde se po shkojmë me këtë në jug”, pasi që i kam dërguar, kur jam kthyer unë pa asnjë dije jam ndalur, kanë dal pasagjeret, unë kam qenë në makinë duke ndejtë kur i pandehuri ka filluar me fyerje dhe sharje, më pas se ku e ka marrë nje shipkë nuk e di dhe më ka ardhur tek kerri e ka hap derën e djathtë nga ana e pasagjerit ndërsa une kam qenë ulur në ulësen e shoferit, i njëjti është munduar me më godit dhe më ka goditur pak në krahun e djathtë dhe në pjesën e trupit ne anën e djathtë. Pastaj B. J. ka ndërhyrë dhe e ka larguar por me fyerje ka vazhdu prap, ndërsa une i kam thënë “hajt se flasim nesër”, më pas kanë ardhur policia unë nuk e di se kush i ka lajmëruar mirëpo i pandehuri nuk ka qenë aty. I pandehuri me shipkë e ka goditur veturën, pjesën e kornizës në anën e djathtë, pra e ka shembur, me të pandehurin nuk kam pasur maosmarrëveshje më parë, dhe nuk e di se cila ka qenë arsyeja pse i njëjti më ka shkaktuar lëndime. Unë kam pësuar lëndime dhe kam qenë te mjeku ditën kritike. Vlera e dëmit të shkaktuar nga i pandehuri ka qenë 30 euro, për çka janë përgjigjur vëllezërit e tij. Dy ditë pas ngjarjes vëllezërit e tij i kanë dëgjuar dy kolegë që të pajtohemi dhe ju kanë thënë atyre që për dëmin e shkaktuar, ne ju përgjigjemi.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.03.2024, në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar V. N. i cili ndër të tjera ka deklaruar se vendi ku ka ndodhur rasti ka qenë tek barrikatat te shkolla teknike në Veri të Mitrovicës, kemi qenë të parkuar me vetura, unë kam qenë në veturen time i shtrirë në karrigën e shoferit, kam qenë si gjysmë fjetur dhe e kam dëgjuar një zhurmë dhe nuk e kam ditur saktë se çfare ka ndodhur, kur jam ngritur e kam parë të ndjerin B. J. në anën tjetër

të rrugës, andaj se kam ndëgjuar dhe e kam pare B. duke e shtyrë M., ka qenë duke e larguar nga vetura e te dëmtuarit Xh. sepse Xh.i ka qenë në veturë brenda, jam dalë jashtë kerrit dhe kishte përfunduar gjithçka, i pandehuri më pas është larguar bashkë me B. tek vetura e të pandehurit M., unë pastaj ju kam afruar Xh. dhe e kam pyetur se “çka ndodhi” i njëjti më tha “dashti mem ra mu ne lidhje me një klient që kinse ja kam marr unë në vlerë 5 Euro, dhe shiko ku ma dëmtoi veturen” e kam parë veturen që ka qenë e dëmtuar pak mbi derën në anën e djathtë. Jam i sigurt se M. ka qenë aty duke punuar Taxi. Të pandehurit nuk i kam parë në dorë asgjë.

Meqenëse dëshmitari B. J. ka ndërruar jetë, gjykata në kuptim të nenit 335 par.1 pika 1.1 të KPK-së, ka lexuar deklaratën e dëshmitarit B. J. e dhënë në polici me datë 23.09.2020 në të cilën ka deklaruar se ditën kritike kam qenë në vendin e punës, në ato momente kam qenë ulur në veturën time duke shikuar në telefonm dhe në ndërkohë e kam dëgjuar një krismë, dikush duke goditur një veturë, kam dalë nga vetura dhe kam vërejtur një person i cili ka pas një shkop në dorë, unë jam nisur në drejtim të tij duke e lutur të qetësohet dhe i njëjti më ka dëgjuar. M. vazhdonte të shante në drejtim të Xh., kurse Xh. vetëm i thoshte se “shihemi”, e në ndërkohë ka ardh edhe personi B. B., i cili ka ndihmuar në qetësimin e situatës. Krismën e shufrës e kam dëgjuar mirëpo nuk e kam parë M. duke e goditur Xh. me shkop. B. B. ka ardh shumë vonë, kurse personi V. N. para se të ndodh rasti, ai ka qenë bashkë me Xh. por nuk mund të flas në emër të tij.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.03.2024, pas administrimit të provave, i akuzuari M. H., ka paraqitur mbrojtjen e tij respektivisht ka zgjedhur të deklarohet për çështjen penale që akuzohet, mes tjerave ka deklaruar se Xh. M. nuk e njoh, të njëjtit nuk i kam shkaktuar lëndime. Ditën kritike kam qenë në shtëpi me nënë time të ndjerë. Dy vëllezërit e mi punojnë si taksist tek prokuroria në Mitrovicë. Dëshmitarin V. N. nuk e njoh. Unë punoj vetëm në Mitrovicën Veriore, jam në dijeni se vëllezërit e mij tani të dëmtuarit Xh. M. i’ a kanë paguar 30 euro, pasi që i njëjti i kishte kërkuar nga ta duke thënë se une ua kam dëmtuar veturën.

Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata pasi dëgjoi dëshmitarët, administroi provat materiale të lartë cekura, pretendimet e palëve, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku nga të cilat gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe deri në fjalën përfundimtare vërtetoi se nuk ishte kontestues fakti se i akuzuari punon si taksist në Mitrovicën veriore. Këtë fakt e kanë pohuar i dëmtuari në të gjitha deklaratat e tij por edhe i akuzuari në deklaratat e tij.

Nuk ishte kontestues as fakti se i dëmtuari kishte pësuar lëndime. Këtë fakt e ka pohuar i dëmtuari Xh. M. në deklaratat e tij mirëpo vërtetohet edhe nga raporti i Spitalit të Përgjithshëm Emergjencë në Mitrovicë.

Nuk ishte kontestues as fakti se të dëmtuarit Xh. M., i janë shkaktuar dëme në veturën e tij. Këtë fakt e ka pohuar i dëmtuari Xh. M. në deklaratat e tij mirëpo vërtetohet edhe nga foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës ku shihen dëmtimet në veturën e tij.

Kontestuese në këtë çështje penale ishte fakti nëse i akuzuari i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit dhe i njëjti me dashje e ka dëmtuar veturën e të dëmtuarit Xh. M. siç pretendon aktakuza.

Gjykata nga provat e administruar ka vërtetuar faktin se i akuzuari, i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit Xh. M., ashtu që fillimisht e ka goditur veturën e të dëmtuarit me shufër të drurit të cilën veturë e ka dëmtuar, e pastaj me të njëjtën shufër e ka goditur të dëmtuarin Xh. duke i shkaktuar lëndime trupore.

Këto fakte gjykata i ka vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit, të dëgjuar si dëshmitar Xh. M. si dhe nga provat e administruara dhe deklaratat e dëshmitarëve.

Gjykata ia ka falur në tërësi besimin deklaratës së të dëmtuarit-dëshmitarit, Xh. M. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, ngase dëshmia e tij përputhej në tërësi me dëshmitë e mëhershme të dhënë në polici, sa i përket fakteve kryesore. Kështu, në deklaratën në polici kishte deklaruar: “një person me emrin M., mbiemrin nuk ia di, i cili punon taksist, ka ardh nga ana e djathtë e veturës sime, fillimisht më ka ofenduar duke më sharë me nanë, pastaj e ka hap derën e pasagjerit të veturës time dhe në dorë e ka pasë një shufër të drurit diku rreth një metër e gjatë, me atë shufër më ka sulmuar në formë të ngulitjes ku më ka goditur në dorë dhe në bri në anën e djathtë, poashtu me të njëjtën shufër e ka goditur veturën time dy herë në anën e sipërme mbi derë”.

Pra, i dëmtuari në të gjitha dëshmitë e tij të dhëna, sikur në polici dhe gjykatë e kishte përshkruar njëjtë ngjarjen, pra mënyrën se si ka ndodhur i gjithë rasti, se si i pandehuri i ishte afruar, e kishte sharë dhe i njëjti i kishte shkaktuar lëndime trupore dhe e kishte dëmtuar veturën e tij. Pra, deklarata e dhënë në shqyrtimin gjyqësor në lidhje me këto fakte përputhej në tërësi me dëshminë e tij në polici, e cila deklaratë ishte dhënë menjëherë pas ngjarjes.

Si përfundim gjykata konstaton se deklarata e dëmtuarit dhënë në polici por edhe dëshmia në shqyrtim gjyqësor është e besueshme. Sipas vlerësimeve të kësaj gjykate, dëshmia e tij është e qartë, e plotë, e kuptueshme pa kundërthënie, e rrjedhshme. Përveç kësaj, ai posedon njohuri se si është zhvilluar ngjarja ngase është edhe i dëmtuar dhe e ka përjetuar drejtpërdrejtë ngjarjen. Dëshmia e tij, përputhet në masë të madhe për faktet kryesore me dëshmitë që ka dhënë më herët në këtë rast. Gjykata, nuk ka vërejtur ndonjë arsye apo motiv që do të shtynin të dëmtuarin për të dhënë dëshmi për ta ngarkuar të pandehurin. Mbi këto arsye kjo gjykate i ka besuar kësaj dëshmie lidhur me faktet kryesore.

Gjykata ia ka falur në tërësi besimin edhe deklaratës së dëshmitarit V. N. dhënë në shqyrtim gjyqësor pasi që e njëjta është në përputhje me provat e tjera të cilat posedon kjo gjykatë si dhe me deklaratën e të dëmtuarit Xh. M..

Gjykata ia ka falur në tërësi besimin edhe deklaratës së dëshmitarit B. J. dhënë në polici me datë 23.09.2020 pasi që e njëjta është në përputhje me provat e tjera të cilat posedon kjo gjykatë si dhe me deklaratën e të dëmtuarit Xh. M. Dëshmia e këtij dëshmitari është lexuar në kuptim të nenit 335 par.1 pika 1.1 e KPPRK-së. Ndonëse ka qenë një deklaratë e dhënë në polici e të cilën palët në këtë rast i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nuk kanë pasur mundësi ta kundërshtojnë, megjithatë gjykata duke u bazuar në diskrecionin e vet e ka lexuar deklaratën e të njëjtit dhe ka bërë vlerësimin e provueshmërisë së asaj deklarate në harmoni me provat dhe rrethanat e rastit. Gjykata leximin e kësaj deklarate e ka bërë duke pasur gjithmonë parasysh ndalesën e paraparë me dispozitën e nenit 257 par.1 e cila përcakton: ‘*Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale*’. Dëshmia e këtij dëshmitari në këtë rast nuk i ka shërbyer gjykatës si provë e vetme apo e një rëndësie vendimtare e që si e tillë do të determinonte vendimin përfundimtar të gjykatës, në këtë rast shpalljen fajtor të të akuzuarit, bazuar vetëm mbi këtë dëshmi.

Prokurorja e Shtetit, gjatë shqyrtimit gjyqësor kishte propozuar që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet B. B., me arsyetimin se i njëjti ka qenë prezent në ditën kritike dhe mund të ofroj dëshmi shtesë lidhur me këtë çështje penale. Mbrojtësi nuk e kishte kundërshtuar këtë propozim. Lidhur me këtë propozim prokuroria nuk ka përcaktuar se çka saktësisht do të vërtetohet nga dëgjimi i dëshmisë së këtij dëshmitari, andaj gjykata ka nxjerr aktvendim me të cilin e ka refuzuar propozimin e prokurorisë, sepse dëgjimi i këtij dëshmitari nuk ishte relevant për çështjen. Për më tepër, këtë dëshmitar Prokuroria e ka pasur të njohur qysh nga faza e hetimeve dhe gjykata kujton se përgjegjëse për zhvillimin e hetimeve është Prokuroria e Shtetit.

Gjithashtu, Gjkata në këtë çështje penale e vlerësoi mbrojtjen e paraqitur nga i akuzuari me rastin e dhënies së deklaratës së tij në shqyrtimin gjyqësor të datës 05.03.2024 dhe konsideron se e njëjta nuk përputhet dhe me gjendjen faktike të konstatuar dhe vërtetuar dhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësuar me ndërgjegje një nga një.

I pandehuri në mbrojtjen e tij, madje vet e pranon se vëllezërit e tij i kanë kompenzuar dëmin të dëmtuarit, e që më miri tregon se i akuzuari e ka ndjerë veten fajtor, dhe familja e tij veç ka qenë në dijeni lidhur me problemin që i akuzuarit M. H. ka pasur me të dëmtuarin në ditën kritike. Për më tepër, i pandehuri deklaron se nuk e njeh fare të dëmtuarin e as dëshmitarët, e që bie në kundërshtim me të gjitha provat dhe dëshmitë tjera të administruara. I pandehuri ka deklaruar se punon vetëm në Mitrovicë, dhe atë vetëm në pjesën veriore të qytetit ashtu si i dëmtuari dhe dëshmitarët, në vendin e dedikuar vetëm për taxi, andaj një deklaram i tillë se nuk e njeh të dëmtuarin dhe as dëshmitarët, për gjykatën paraqet tentativë për shmangie nga përgjegjësia penale, dhe nuk përkon me gjendjen reale. Gjkata, prandaj, nuk ia fali besimin pasi që deklarata e tij nuk ishte bindëse për gjykatën, dhe kishte kundërrthënie të atilla që e bënin plotësisht jo të besueshme.

Gjkata e vlerësoj edhe pretendimin e mbrojtësit të të pandehurit, se i njëjti sa i përket veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së të lirohet nga akuza, pasi që sipas mbrojtësit në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër të rëndësisë së vogël ashtu siç e përcakton neni 11 i KPRK-së. Neni 11 i KPRK-së përcakton: *“ Nuk përbën vepër penale ajo vepër e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuar me ligj, paraqet vepër të rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj është e parëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës; mungesës ose pasojave të dëmshme të*

parëndësishme; rrethanave në të cilat është kryer vepra; shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose rrethanave personale të kryesit''. Gjykata gjeti se ky pretendim nuk qëndron. Ndonëse është e vërtetë se dëmi i shkaktuar nuk ka qenë i madh, mirëpo kjo vepër i ka paraprirë veprës tjetër të cilën e ka kryer i pandehuri, dhe për t'u vlerësuar një vepër e rëndësisë së vogël, janë vendimtare të gjitha elementet objektive dhe subjektive që përbëjnë figurën e posaçme të veprës penale të kryer. Këto elemente janë, p.sh., mënyra e kryerjes së veprës, vendi dhe koha e kryerjes, mjetet që janë përdorur për ta kryer, forma e fajësisë, marrëdhënia e kryesit dhe viktimës, qëllimi i kryesit, jeta e tij e mëparshme dhe rrethanat e ngjashme. Fakti se i pandehuri e ka kryer veprën duke përdorur një shkop të drurit, dhe e ka goditur veturën deri sa në të gjendej edhe i dëmtuari, e pasi që e ka dëmtuar veturën e ka sulmuar edhe të dëmtuarin, atëhere në rastin konkret, vepra e kryer nuk mund të konsiderohet si vepër e rëndësisë së vogël dashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza mbi këtë bazë.

Nga procesverbali i marrjes së deklaratës së të dëmtuarit Xh. M. në polici me datë 17.09.2020, gjykata vërteton faktin se i pandehuri M. H. me një shufër i ka shkaktuar lëndime trupore tani të dëmtuarit Xh. M. si dhe të njëjtit i'a ka dëmtuar veturën.

I pandehuri M. H., në polici me datë 18.09.2020, ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore që të mbrohet në heshtje.

Nga procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin B. J. në polici me datë 23.09.2020 vërtetohet fakti se ditën kritike dy taksistë kanë pasur një problem në mes vete ashtu që i pandehuri M. H. ka pasur një shkop në dorë si dhe e ka sharë të dëmtuarin Xh. M., mirëpo i dëmtuari vetëm i kishte thënë "shihemi".

Nga procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit V. N. në polici me datë 24.09.2020 i vërtetohet fakti se me datë 17.09.2020 në Mitrovicë- veri dy taksistë kanë pasur një problem në mes vete dhe atë M. H. dhe Xh. M.

Nga Foto dokumentacioni vërtetohet fakti se i dëmtuari Xh. M. ka pësuar dëmtime në veturën e tij, si dhe shihet shufra të cilën i pandehuri e ka përdorur për kryerjen e veprave penale.

Nga Raporti Policor i oficerit I. U. vërtetohet fakti se me datë 17.09.2020, dy persona të cilët punojnë si taksist kanë pasur një problem më mes vete, në vendin engjarjes policia ka fotografuar

një shkop i cili është përdorur nga ana e të pandehurit e poashtu edhe veturën e dëmtuar nga ai shkop. I dyshuari e ka hapur derën e pasagjerit dhe me shufër e ka goditur në mënyrë të ngulitjes së dëmtuarin dhe si pasojë e ka goditur në dorë por edhe në pjesën e brinjëve. I dëmtuari është dërguar për kontroll mjekësor.

Nga raporti mjekësor me numër 15624 lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm Emergjencia në Mitrovicë për të dëmtuarin Xh. M., vërtetohet se i njëjti ka pësuar lëndime trupore për të cilat ka marr edhe trajtim mjekësor.

Nga ekspertiza mjeko-ligjore e datës 27.10.2020 vërtetohet fakti se i dëmtuari Xh. M. ka pësuar dëmtime të cilat paraqesin kontuzion në anën e djathtë të toraksit dhe dërmishje në krahun e djathtë të shkaktuar nga ndonjë mjet i fortë dhe i rëndë mbretës, dhe të njëjtat bëjnë paraqesin lëndime të përkohshme të shëndetit dhe kualifikohen lëndim i lehtë trupor.

Si përfundim, Gjykata dhe njëherë rithekson se, në këtë çështje penale nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarit, janë plotësuar të gjitha elementet dhe i akuzuari ka kryer veprat penale – Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 dhe 1 pika 1.4 të KPRK-së dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas dispozitës, së nenit 185 par. 2 të KPRK-së, është përcaktuar: *“Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”*.

Sipas dispozitës, së nenit 321 par.1 të KPRK-së, është përcaktuar: *“Kushdo që e asgjëson, dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara në nenin 322 të këtij Kodi, dënohet me gjobë ose burgim deri në një (1) vit”*.

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor përtej çdo dyshimi vërtetohet se i akuzuari kishte ndërmarr veprimet në drejtim të kryerjes së veprave penale ashtu që, Me datë 17.09.2020, rreth orës 11:30 në rrugën “...” në Mitrovicë veri, i pandehuri me dashje i ka shkaktuar lëndime trupore personit tjetër dhe atë të dëmtuarit Xh. M., ashtu që fillimisht e godet veturën e të dëmtuarit me një shufër të drurit pastaj me të njëjtën shufër e godet edhe të dëmtuarin Xh. duke

i shkaktuar lëndime trupore dhe atë kontuzion në anën e djathtë të toraksit, dërmishje në krahun e djathtë të shkaktuar nga ndonjë mjet i fortë dhe i rëndë mbretës që si të tilla paraqesin lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin dhe Me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, i pandehuri me dashje ka dëmtuar veturën e tashmë të dëmtuarit Xh., ashtu që i pandehuri me një shufër të drurit e godet veturën e llojit Mercedes me targa regjistrimi pronë e të dëmtuarit Xh. M. me ç' rast i dëmton të njëjtën në pjesën e sipërme të automjetit mbi dyer.

Përveç elementeve të përgjithshme, gjykata gjen se në veprimet e të akuzuarit, janë përmbushur edhe elementet e veçanta të veprës penale. Kjo për faktin se i akuzuari në këtë rast kishte vepruar me dashje direkte.

Prandaj, si përfundim Gjykata, nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar për tej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprat penale: Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 dhe 1 pika 1.4 të KPRK-së dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit:

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së.

Nga verifikimi i kryer në Sistemin Qendror të Evidencës Penale, rezulton se i njëjti në fakt ka qenë i dënuar më parë me aktgjykimet P-338/2001, P-307/2001 dhe P-265/2003 por rezulton se këto dënime janë shlyer nga evidenca e të akuzuarit dhe është arritur rehabilitimi, andaj duke pasur parasysh se për të njëjtin aktualisht nuk figuron ndonjë aktgjykim i plotëfuqishëm atëherë këtë fakt gjykata e mori si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimit. Rrethanë tjetër lehtësuese gjykata gjeti gjendjen e e dobët ekonomike të të akuzuarit, gjithashtu faktin se dëmi i shkaktuar ka qenë i vogël dhe është kompenzuar nga familjarët e të akuzuarit. Ndërsa, si rrethana rënduese për të akuzuarin, jashtë elementeve të figurës së veprave penale, gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, kontributin thelbësor në kryerjen e këtyre veprave penale, faktin se nuk ka shprehur keqardhje apo pendesë pas rastit, ndërsa rrethana tjera rënduese nuk pati.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e këtyre veprave penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, në kompensimin e palës së dëmtuar për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Kërkesa pasurore juridike:

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata vendosi konform nenit 462 të KPP-së.

Shpenzimet e procedurës:

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, Gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, par. 2, pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të LIGJI NR. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.882/20, datë 04.04.2024

G j y q t a r j a

Marigona Lajqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.